

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Deklarata e Floriana Garos - PD: Nafta në Shqipëri 2.48 euro, më e shtrenjtë se në Gjermani dhe Norve gjì! Përgjegjës është vetëm Rama
ADRESA	https://www.syri.net/politike/916782/pd-nafta-ne-shqiperi-2-48-euro-me-e-shtrenjte-se-ne-gjermani-dhe-norvegji-pergjegjes-eshte-vetem-rama/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 11:28:10 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 11:20:11 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f574cbe8660ef638259e386e959a0f8494d07b2bf992a3c708daccbc5ed05f6a
TEKSTI	7abc4e12df8a0ecb5209ffb0b1425b6ba6b3eec38fba10195fc07cb6a477ef24
PAMJA	8cc59754ff9ab2f00eca8c11c60d647a22aa7deb655853944c7911b6d275ec1d

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	9a0ca5d36e457d474a1ed139de990bac7d930d480f1ea394ff9344028a54bbb5
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	93a0feb7bb19154a540f480bce1eeee0b2224e0180d4198842f090d06654d15a
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/9a0ca5d36e457d474a1ed139de990bac7d930d480f1ea394ff9344028a54bbb5>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



IRENA BEQIRAJ

Fashizmi nuk duhet kërkuar tek revolta e protestuesve por në Kuvend!



AGIM XHAFKA

Dialog me mbesën

më të lexuarat

Zhupa: Nga shkollat me turne te emigrimi i të rinjve, problemet mbeten të njëjta, fëmijët paguajnë çmimin

'Mafia emëron ministrat në qeverinë Rama', Kepi: E kanë të lehtë të gjejnë personin e duhur për aferat e tyre

Nafta këtu më shtrenjtë se në Europë, Bozdo: Situata, emergjente! Qeveria të ndërhyjë me lehtësira fiskale

Muzeu hebraik në Vlorë/ Nezini: Godina i përket Klubit Labëria, po zhduket historia

PD: Shpopullimi i Shqipërisë, një krizë që po zbraz vendin dhe po rrezikon të ardhmen e tij

'Diaspora nuk ka për t'ia falur Ramës! Shqiptarët e bashkuar pushteti i tmerruar! Dita e 105 e protestës në foto

PD: Nafta në Shqipëri 2.48 euro, më e shtrenjtë se në Gjermani dhe Norvegji! Përgjegjës është vetëm Rama

13:20, 15/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Shqipëria dje shënoi çmimin prej 2.48 euro për litër naftë, duke u renditur e para në Ballkan dhe e dyta në kontinent, pas Danimarkës, me çmimin më të shtrenjtë.

Zëdhënësjja e PD-së, Floriana Garo theksoi se nafta 229 lekë nuk është thjesht një produkt dhe një çmim, por është një politikë e vjedhjes me anë të rritjes së taksave.



"Shqiptarët duhet ta kenë të qartë se çdo ditë që qëndron Rama dhe banda e tij në krye të shtetit, aq më shumë rritet rëndesa ekonomike dhe ulët siguria. Shqiptarët duhet të kuptojnë se përgjegjës për këtë gjendje nuk janë konfliktet botërore, siç gënjen Rama, sepse e njëjta gjë do të kishte ndodhur edhe në Maqedoni dhe Kosovë. Përgjegjës për këtë gjendje është vetëm një njeri dhe e ka emrin Edi Rama." theksoi ajo në një deklaratë për median nga selia e PD-së.

Ajo i bëri thirrje demokratëve, socialistëve dhe të pavarurve t'i bashkohen protestës qytetare merr vlerë sot më shumë se kurrë duke theksuar se "Rama, jepe dorëheqjen" dhe 'zgjedhje të lira garantuar nga një qeveri kujdestare', nuk janë ankesa dhe kërkesa, por domosdoshmëri kombëtare!

Deklarata zëdhënëses së PD, Floriana Garo:

Shqipëria dje shënoi çmimin prej 2.48 euro për litër naftë, duke u renditur e para në Ballkan dhe e dyta në kontinent, pas Danimarkës, me çmimin më të shtrenjtë.

Të dhënat janë marrë nga Buletini Javor i Komisionit European dhe rezultojnë se Shqipëria, për çmimin e karburantit, lë mbrapa vende si Holanda, Gjermania, Norvegjia, por rezultojnë e fundit për standardin e jetesës.

Nafta 229 lekë nuk është thjesht një produkt dhe një çmim, por është një politikë e vjedhjes me anë të rritjes së taksave.

Fakt është që secili nga vendet kufitare me ne nuk e ka ndryshuar çmimin as dje, as sot: Mali i Zi e shet me 1.87 euro, Kosova me 1.76–1.85 euro, Maqedonia e Veriut me 1.64 euro.

Ullëria që është vend që luftë e ka çmimin e naftës 1.25 euro për litër

Orizimi, që është vlerë në lirinë, e ka çmimin e natës 1.71 euro për litër.

Pse, vendet e rajonit e kanë shumë më të lirë çmimin e naftës se Shqipëria?

Kjo vjen për shkak të politikave që ndjekin. Qeveria e Malit të Zi e ka ulur akcizën e naftës deri në 50% në kohë krizash.

Serbia deri në 25% dhe ka aplikuar çmime tavan.

Maqedonia e Veriut aplikon vetëm dy taksa kryesore, akcizë dhe TVSH, ndërsa taksa e qarkullimit merret direkt tek automjetet, dhe jo përmes çmimit për litër të karburantit, duke e mbajtur barrën fiskale më të ulët.

Kosova ka përdorur herë pas here rregullimin e përkohshëm të marzheve dhe çmimeve maksimale të tregtimit përmes vendimeve të ministrisë përgjegjëse për tregtinë.

I vetmi që nuk pranon të marrë asnjë masë, por të vijojë të shtojë barrën fiskale për shqiptarët dhe familjet e tyre, është Edi Rama.

Partia Demokratike, në fushatën elektorale të vitit 2025, premtoi përgjysmimin e taksave të karburantit, ndërkohë që këtë kërkesë ia ka drejtuar publikisht edhe qeverisë Rama.

Në rast se do të ndiqej kjo politikë, çmimi i naftës sot do të ishte 1.71 euro për litër, pra në mesataren e rajonit dhe jo ndër çmimet më të shtrenjta në Evropë.

Shqiptarët duhet ta kenë të qartë se çdo ditë që qëndron Rama dhe banda e tij në krye të shtetit, aq më shumë rritet rëndesa ekonomike dhe ulet siguria.

Shqiptarët duhet të kuptojnë se përgjegjës për këtë gjendje nuk janë konfliktet botërore, siç gënjen Rama, sepse e njëjta gjë do të kishte ndodhur edhe në Maqedoni dhe Kosovë.

Përgjegjës për këtë gjendje është vetëm një njeri dhe e ka emrin Edi Rama.

Prandaj thirrja që demokratët, socialistët dhe të pavarurit t'i bashkohen protestës qytetare merr vlerë sot më shumë se kurrë.

'Rama, jepe dorëheqjen' dhe 'zgjedhje të lira garantuar nga një qeveri kujdestare', nuk janë ankesa dhe kërkesa, por domosdoshmëri kombëtare!

© SYRI.net

Lexo edhe:



Rama merr 245 aplikime për të punuar me 'agjencinë e propagandës së regjimit'



Edhe Franca u bën thirrje shtetasve të saj në Kosovë: Tregoni vigjilencë, qëndroni larg tubimeve



Përgjimi e vulosi, Rama ia ka shitur totalisht qeverinë mafias, SPAK ku je?

Urimi dhe mesazhi i Metës: PISA janë një tjetër dëshmi e gjendjes alarmante të shkollave! Për PL-në arsimi prioritet

Ngërçi me pagat/ Gjykata e Kukësit mbyll dyert për qytetarët 3 ditë

Shkërmoqen iluzionet e Erion Veliajt, mbetet në burg!

TË NGJASHME



Pagat e magistratëve/ Bardhi: S'mund t'i trajtojmë për lëmshë, nisma e PS do rrezohet sërish në GJK



SYRI TV/ Daja i Zegjine Çaushtit përdhunon 34-vjeçaren dhe i masakron babanë, rrëfimi tronditës: Duam mbrojtje



VIDEO/ Erion Veliaj, si të duket qelia? Protestuesit festojnë vendimin e Gjykatës së Lartë



Ndërron jetë Flora Brovina, nesër do të dëshmonte për Masakrën e Dubravës



Pagat e magistratëve, Bardhi: Vendimin e GJK s'mund ta adresojë asnjë punonjës i administratës



Shkërmoqen iluzionet e Erion Veliajt, mbetet në burg!



Ngërçi me pagat/ Gjykata e Kukësit mbyll dyert për qytetarët 3 ditë



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë me me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.